



STË SIGURT PËR ZGJEDHJE. LËVIZ. ME ZGJUARSI

NË RRUGËN E "PO"-VE DHE "JO"-VE 3/4/5 vjeç

progetto promosso da



con il patrocinio di



Ministero dell'Istruzione e del Merito
Ufficio Scolastico Regionale per il Piemonte
Ufficio VI - Ambito territoriale di Cuneo

in collaborazione con





INDEKSI

Fëmijët, trafiku, udhëtimi të përballueshëm (alternativë ekologjike)
Një rrugë e zakonshme (rutinë)
Fëmijët dhe perceptimi i rrezikut në trafikun urban
Përvoja të përditshme për një fëmijë këmbësor i shoqëruar (nga një i rritur)
Sjelljet e njerëzve të rritur
Orientimi drejt lëvizshmërisë së përballueshëm (alternativë ekologjike)

Fëmijët, trafiku, udhëtimi të përballueshëm

Nga qytetet e mëdha deri te fshatrat e vegjël, përditshmëria e secilit prej nesh është e përshkruar nga lëvizjet, qoftë të kalojmë hapësirën urbane apo të lëvizim në atë jashtë-urbane për të arritur në shkollë, në punë apo për t'u kthyer në shtëpi. Një rutinë e bërë nga rregulla të domosdoshme për të lëvizur në mënyrë të sigurt, por gjithashtu nga zakonet dhe pakujdesitë e vogla që mund të na bëjnë të harrojmë rëndësinë e kujdesit dhe rregullave.

Projekti "Të Sigurt për Zgjedhje. Lëviz. Me zgjuarsin" ("Sicuri per Scelta. Muoversi. Con intelligenza") është një iniciativë dedikuar edukimit mbi sigurinë rrugore dhe udhëtimi të përballueshëm (alternativë ekologjike), që synon qëllimet e mëposhtme: të ndërgjegjësojë të gjithë përdoruesit e rrugës për respektimin e rregullave, të promovojnë një njohje të saktë të rrezikut, të orientoj drejt zgjedhjeve të përballueshme për mjedisin (*alternativë ekologjike*).

Kjo broshurë përfshin disa sjellje që duhen ndjekur në rrugë për të garantuar sigurinë e fëmijëve të moshës tre, katër dhe pesë vjeç. Përmes historive të miqve tanë Iriqë, shqyrtohen veçanërisht veprimet e **këmbësorit të shoqëruar** në rrugët e zakonshme si, për shembull, rruga shtëpi-shkollë-shtëpi.

Një rrugë e zakonshme (rutinë)

Për çdo fëmijë, rruga nga shtëpia në shkollë lidh dy vende me rëndësi emocionale. Në përgjithësi, të rriturit i kushtojnë shumë vëmendje për ta bërë mikpritës dhe të sigurt ambientin ku fëmijët kalojnë kohën më të madhe, por priren t'i kushtojnë pak rëndësi autonomisë së fëmijës në rrugë. Ashtu siç janë 'ambienti' shtëpia dhe shkolla, ashtu është 'ambienti jetës' edhe rruga, trotuari, shkallët dhe rrëshqitësja, kalimi i këmbësorëve – vijat e bardha, sinjalet rrugore, semafori, kryqëzimet, urat, ndërtesat, automjetet, njerëzit, dhe kafshët (shtëpiake ose të egra), parqet publike dhe çdo element tjetër që përbën një qytet, një fshat, një lagje.

Arritja në shkollë me makinë, në këmbë, me biçikletë ose me autobusin shkollor i lejon fëmijët të familjarizohen me elementët e këtij "ambienti të përbashkët" me të cilin duhet të përballen.

Rruga e përditshme shtëpi-shkollë-shtëpi mund të jetë një mundësi për të dhënë mësim të rëndësishëm për sigurinë e tij personale dhe i rrituri mund të ndihmojë që ti mësojnë në mënyrë efektive.



Fëmijët dhe perceptimi i rrezikut në trafikun urban

Para së gjithash, duhet kujtuar se një fëmijë nuk mund të krahasohet me një të rritur të vogël: mënyra e tij e të parit, të njohurit dhe të mësuarit është shumë e ndryshme nga mënyrat tona. Mjedisi rrugor, gjithashtu, është i pasur me simbole që duhen deshifruar, jo të menjëhershme të kuptueshme nga ana e fëmijës.

Si mund të bëjmë që ato të bëhen burim orientimi dhe sigurie në vend që të gjenerojnë ndjenjë konfuzioni dhe, si pasojë, të refuzohen sepse janë ngatërruese?

Kompleksiteti i madh i trafikut urban krijon fillimisht habi te fëmija, ndjekur nga vështirësitë në interpretimin e tyre, me pasiguri që mund të shkaktojnë reagime frike, ose, në të kundërtën, trimëri të tepruar.

Këto reagime janë për shkak të mënyrës se si fëmija percepton mjedisin rrugor:

- Gjatesia e tij ndikon në fushën vizive, e cila është ende e ngushtë;
- kuptimi i zhurmave komplekse dhe lokalizimi i tyre janë në proces që varet nga fazat të pjekurisë;
- disa koncepte hapsinore janë të vështira për t'u pasqyruar në raport me objektet dhe hapësirën, për shembull si të vlerësojmë nëse është majtas ose djathtas ardhja e mjeteve në një kalim për këmbësorë;
- trafiku paraqet një numër të madh stimulsh perceptuese në të njëjtin moment, por aftësia e kufizuar e përqendrimit të një fëmije e ndihmon pak të perceptojë rrugën në tërësinë e saj;
- aftësitë fizike janë duke u konsoliduar: për shembull, një fëmijë, mund të pengohet akoma;
- ende nuk ka aftësinë për të kuptuar dallimin midis një automjeti të ndalur dhe atij në lëvizje.



Bëhet fjalë për faktorë që ndikojnë në vlerësimin e shpejtësisë së një automjeti në afërsi: Në rrugët urbane lëvizet me shpejtësi të ndryshme dhe për fëmijën është e ndërlikuar të kuptojë se çfarë ndodh rreth tij.

Për më tepër, një fëmijë prirët të veprojë papritur pa menduar për pasojat:


Reagimet e tij të papritura mund të jenë të paparashikueshme dhe të përbëjnë një burim të paqëllimshëm rreziku, për veten dhe për të tjerët. Për shembull, mund të tërhiqet nga diçka dhe papritmas të fillojë të vrapojë.



Në familje dhe në shkollë, fëmijët gjenden në ambient të mbrojtur edhe pse mësojnë disa sjellje të duhura, vështirësia e vërtetë është ti zbatojnë ato më pas në kontekstin e rrugës ku sjelljet e duhura duhen të zbatohen: automjetet në lëvizje mund ti krijojnë fëmijës një ndjesi çorientimi.

Kur distanca nga shtëpia në shkollë e lejon, do të ishte shumë e dobishme të shoqëroni fëmijën në këmbë, për një sërë arsyesh të rëndësishme. Ja disa prej tyre:

- nëpërmjet përvojës së ecjes në trafikun urban dhe falë dialogut me të rriturit e përgjegjshëm, fëmija mëson gradualisht të njohë rreziqet derisa të bëhet i vetëdijshëm për to dhe, më pas, duke u rritur, t'i vlerësojë në mënyrë të saktë, derisa të fitojë aftësinë për t'i parashikuar dhe shmangur ato. Njohja dhe vlerësimi i një rreziku në një mjedis të njohur është më i thjeshtë krahasuar me përballjen me të në një situatë të re dhe të papritur.
- gradualisht fëmija bëhet i vetëdijshëm për distancat dhe kohën e udhëtimit;
- përshkimi në këmbë nga shtëpia në shkollë kthehet në një ushtrim fizik i përditshëm në ajër të hapur që është i dobishëm për fëmijët, përmirëson aftësitë fizike, ndihmon në shkarkimin e tensioneve dhe stërvit aftësinë për t'u përqendruar;
- duke ecur në këmbë nga shtëpia deri në shkollë, ndihmon në uljen e numrit të makinave në afërsi të shkollës, duke rritur gjithashtu sigurinë e këmbësorëve të vegjël.



Përvojat e përditshme për fëmijën këmbësor të shoqëruar

Përshkrimi i përditshëm në këmbë e në të njëjtin segment rrugor në të njëjtën kohë bëhet një shans i mirë për të mësuar në mënyrë natyrale dhe konkrete të njohjes të disa rreziqeve të përsëritura dhe të kuptoj domethënien e rregullave kryesore të sjelljes. Sidomos nëse ky segment rrugor përshkohet në këmbë.

Gjatë një rrugë të njohur mund t'i tregohen fëmijës pikat më të rrezikshme për këmbësorin, duke përdorur shpjegime të thjeshta për të shpjeguar arsyet dhe duke treguar sjelljet më të kujdesshme për atë segment.

Përmes përsëritjes së sjelljeve të duhura dhe duke imituar shembullin pozitiv të të rriturve, fëmijët përvetësojnë gradualisht përvojën e nevojshme për të lëvizur në mënyrë autonome dhe të sigurt, duke u familjarizuar me mjedisin rrugor.

Mund të ndodhë që një lëvizje e papritur të shkaktojë rrëzimin e fëmijës (duke ecur, duke qenë me biçikletë, duke zbritur nga makina): sa gjëra mund të mësohen nga një gju i gërvishtur! Kërkohe me durim një ekuilibër mes asaj së mbrojtjes së fëmijës nga familjarët dhe nevojës për të eksploruar mjedisin në mënyrë të pavarur.



Megjithatë kujdes për sjelljet tona: ndonjëherë, për shkak të ngutjes, një këmbësor i rritur që shoqëron një fëmijë ka tendencën ta “tërheqë” atë, mbase kalon në këmbë me semafor të kuq, ndoshta flet në celular gjatë kalimit, duke u shpërqendruar nga konteksti dhe duke humbur kontrollin e plotë mbi veprimet e fëmijës.

Sjelljet e njerëzve të rritur

Fëmija, që në moshë të hershme, fillon të zhvillojë përvojat e tij personale në lidhje me rrezikun rrugor dhe është detyra e të rriturit ta sigurojë atë, duke vazhduar të kujdeset për sigurinë e tij.

Disa masa ndihmojnë në përshtatjen e fëmijës me mjedisin rrugor, si për shembull të dalë nga shtëpia në kohë kështu shmang ankthin e mbërritjes me vonesë; gjithashtu, qoftë në këmbë, qoftë në makinë, është mirë të flitet me të.

Jo gjithmonë arrijmë të kuptojmë, por fëmijët na vëzhgojnë: për të përvetsuar zakonet e respektimit të sinjaleve rrugore, shembulli i të rriturit vlen më shumë se çdo mësim, edhe kur këmbësori i rritur vë në dukje sjelljen e gabuar të shoferit që nuk ndalet para vijave të bardha.

Ndonjëherë, mund të shpjegohen me fjalë të thjeshta pasojat e mundshme të një sjelljeje të gabuar, por do të ishte më mirë të ndalemi te sjelljet pozitive dhe të lavdërojmë fëmijën kur ai sillet në mënyrë të duhur.

Keni kujdes edhe ndaj veshjes së fëmijës këmbësor: një këpucë e lidhur keq, një shall që valvitet në erë, një xhup që nuk i përshtatet temperaturës së periudhës mund të pengojnë lëvizjet dhe të krijojnë parehati, duke shkaktuar shpërqendrim ndaj mjedisit të jashtëm.

Të ecësh në rrugë është një veprim i lodhshëm, që kërkon përqendrim dhe gatishmëri për vetëmbrojtje, ndonjëherë fëmija ka vështirësi të ndahet nga një objekt që e don shumë, por të ecësh në trafik duke mbajtur lodrën e preferuar në dorë mund të jetë një tjetër faktor i mundshëm shpërqendrimi.

Edhe në këto situata, është i rrituri ai që mund të drejtojë fëmijën drejt vetërregullimit të sjelljes së tij.





Një rregull themelor në trafik: **shiko dhe të shohin**. Çfarë do të thotë kjo?

Për ne shoferë të rritur kërkon një vëmendje të veçantë kur takojmë një person të pambrojtur, duke kujtuar gjithashtu se një makinë e parkuar keq mund të pengojë pamjen për të kaluar rrugën ose të pengojë kalimin në trotuar. Ndërsa drejtojmë makinën gjatë natës, kemi prirjen të përqendrohemi veçanërisht tek objektet e ndriçuara: kujtojmë se një këmbësor me veshje të errëta dhe pa elemente reflektuese është i dukshëm deri në një distancë prej rreth 25 metrash, ndërsa veshjet e ndritshme dhe me reflektueshmëri të lartë e bëjnë atë të dukshëm nga një distancë prej rreth 140 metrash.



Për fëmijët këmbësorë, do të thotë të mësojnë të bëhen të dukshëm në trafik, gjithmonë dhe veçanërisht në ditët me mot të keq, për shembull, duke veshur një jelek me dukshmëri të lartë dhe veshje të qarta, ose duke shtuar një element reflektues në çantën e shpinës, në kapelë, ose në këpucë. Edhe një dritë me intervale në çantën e shpinës mund t'i pëlqejë fëmijës: por në praktikë nuk zëvendëson elementin reflektues pasi nuk emeton dritë të mjaftueshme për sigurinë në rrugë..

Orientimi drejt lëvizshmërisë së përbalueshëm (alternativë ekologjike)

Në mënyrë të qartë, së bashku me fëmijën, gjatë çfarëdo lëvizjeje përgjatë një rruge urbane, është për shembull, e dobishme të vërehen mënyrat e ndryshme të lëvizjes në qytet, në fshat, në lagje dhe vlerësimi i karakteristikave të tyre, pozitive dhe negative. Njëkohësisht duhet kujtuar se në këtë moshë, fëmijët tërhiqen nga aspektet e dukshme të objekteve (për shembull, përmasat e një autobusi) dhe përqendrojnë vëmendjen në një objekt një nga një, pasi ende po zhvillojnë aftësinë për të krahasuar.

Së pari, është mirë të shqyrtohet veçmas çdo element i mjedisit rrugor, duke e konsideruar atë nga çdo pikëpamje perceptuese (shikimi, dëgjimi, nuhatja, për disa elementë edhe prekje). Kjo aftësi (e quajtur diskriminim) mund të duket shumë e thjeshtë, por është baza për zhvillimet e ardhshme dhe duhet të përvetësohet në mënyrë të përsosur për t'u zbatuar menjëherë.

Është për t'u kujtuar faktin që fëmijët priren të konsiderojnë disa mjete (për shembull, biçikletat dhe skuterët me shtyrje) si lodra, dhe kur i drejtojnë ata nuk i kushtojnë shumë vëmendje trafikut.

Për ata që jetojnë jashtë qendrave të banuara, është e vështirë të reduktohet përdorimi i makinës për të çuar fëmijën në shkollë; megjithatë, mund të krijohen situata që t'i japin fëmijës përvojën e këmbësorit të shoqëruar, për shembull

duke parkuar në një distancë të caktuar nga ndërtesa e shkollës. Në disa vende, për shembull në lagjet e vogla, fëmijët përjetojnë kënaqësinë e të luajturit në oborr ose në rrugë private me pak trafik, prandaj i vogli mund të vrapojë, pedalojë dhe luajë lirshëm: sa herë që shkohet në qendrën e qytetit ose në qytet, është mirë të ndihmohet fëmija të dallojë hapësirat private nga ato publike, përmes të cilave ai mund të ndeshë reziqe të panjohura për të.

Së fundmi, një udhëtim për të arritur një vend më të largët mund të përfshijë përdorimin e mjeteve alternative si anije, aeroplan ose tren: është një mundësi për t'i mësuar fëmijës të reflektojë mbi sistemin e transportit në tërësi dhe ndikimet e ndryshme në mjedis.

Ja disa shembuj të vëzhgimeve në rrugë:

automjetet me motor: cilat janë, sa rrota kanë; prodhojnë zhurmë dhe ndotje, janë të shpejtë dhe mund të jenë të rrezikshëm; një autobus është shumë i madh dhe transporton shumë njerëz; një autobus transporton më shumë njerëz se një makinë;

biçikletat: udhëtojnë në pistat e biçikletave; në rrugë zënë më pak hapësirë; janë të qeta; nuk prodhojnë erë të keqe; kokorja mbron kokën;

këmbësori: ecën në trotuar pa vrapuar; trotuari ka një prag për të mbrojtur këmbësorin nga mjetet.; ndonjëherë disa këmbësorë zënë gjithë hapësirën dhe këmbësorët e tjerë nuk mund të kalojnë; gjatë ditës, mund të jem këmbësor i shoqëruar për të shkuar në ... (shkollë, për të vizituar një mik, në park, për të bërë pazarin, në palestër, në laborator teatër/muzike ... në **rrugë**: secili ka një vend për të lëvizur, me respekt ndaj të tjerëve

